



Njoftim për Shtyp nr. 15/119  
PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME  
17 mars 2015

Fondi Monetar Ndërkombëtar  
Uashington, D.K. 20431 SHBA

### **Deklaratë në përfundim të Misionit të FMN-së në Shqipëri**

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), nën drejtimin e zotit Nadeem Ilahi, vizitoi Tiranën gjatë periudhës 4-17 mars 2015, për të zhvilluar diskutime për shqyrtimin e katërt të Shqipërisë të Marrëveshjes së Fondit të Zgjeruar (EFF). Në fund të vizitës, zoti Ilahi mbajti këtë deklaratë:

“Programi ekonomik i Shqipërisë po ecën sipas planit. Ekipi i FMN-së arriti një marrëveshje në nivel stafi me autoritetet, për politikën që nevojiten për të përfunduar shqyrtimin e katërt të EFF-së.

Shkalla e rritjes ekonomike parashikohet të vazhdojë rimëkëmbjen e moderuar në vitin 2015, duke arritur rreth 3 për qind, pavarësisht përmbytjeve të kohëve të fundit dhe ngadalësimit në sektorin e naftës. Rritja ekonomike do të nxitet nga rimëkëmbja e qëndrueshme e kërkesës së brendshme, duke përfutur nga çmimet e ulëta në fushën e energjisë dhe norma të ulëta interesi, si edhe nga një rritje graduale e huadhënies bankare. Por prodhimi vazhdon të jetë nën potencial, dhe së bashku me presione të dobëta nga mjedisi i jashtëm do të kontribuojë që inflacioni të mbetet i ulët.

Ecuria fiskale gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014 ka qenë përgjithësisht në përputhje me objektivat e programit. Autoritetet vijojnë të mbeten të angazhuara për arritjen e objektivit të deficitit fiskal për vitin 2015, si edhe për t’i kufizuar shpenzimet brenda paketës së programuar.

Politika monetare duhet të vazhdojë të mbështesë rimëkëmbjen ekonomike, në përputhje me mandatin e Bankës së Shqipërisë për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Rritja e kreditimit po rigjallërohet por vazhdon të mbetet e ulët, e prekur nga niveli i lartë i kredive problematike dhe dobësitë në fushën e ekzekutimit të kontratave. Ne mirëpresim angazhimin e autoriteteve për të hartuar një strategji gjithëpërfshirëse që adreson çështjen e kredive me probleme me synim për të përmirësuar mjedisin e kreditimit.

Zbatimi i reformës në sektorin energjetik po ecën sipas planit. Reforma është hartuar në konsultim me Bankën Botërore dhe është e nevojshme për zvogëlimin e risqeve fiskale. Vjedhja e energjisë elektrike, edhe pse në nivele të larta, po zvogëlohet; tarifat janë përshtatur, të ardhurat po rriten; dhe ndërmarrjet shtetërore në sektorin energjetik po reformohen.

Bordi Ekzekutiv i FMN-së pritet të diskutojë për shqyrtimin e katërt në mes të vitit 2015. Aprovimi i shqyrtimit do të mundësonte lëvrimin e 28,9 milion SDR (rreth 37.4 milion Euro). Programi 36-mujor në formë EFF-je për Shqipërinë është miratuar më 28 shkurt 2014.” (shiko [Press Release 14/81](#)).